

DITARI MUJOR MAJ 2024



ZHVILLIMI I PARQEVË DHE ZONAVE PËR ZHVILLIM TEKNOLOGJIK DHE EKONOMIK ËSHTË NJË NDËR PRIORITETET KRYESORE TË MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

TEDA dhe DURANA PARK, dy hapa historikë për politikën tona qeveritare, dy zhvillime risi për ekonominë shqiptare, me dy zhvillues publik. Vijnë takimet me grupet e interesit për informim dhe orientim mbi këto mundësi.

Me projekte të tilla, dhe të tjera që do pasojnë, synojmë të tërheqim investitorë, kapitale dhe njohuri në sektorët me inovator të ekonomisë.

VIZITË ZYRTARE NË BUDAPEST, HUNGARI



Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në vizitën zyrtare të zhvilluar në Budapest pati fokus politik, reformat dhe strukturat hungareze, projektet dhe programet kryesore sektoriale, ku u njoh gjerësisht me eksperiencat dhe praktikën më të mirë me rezultate konkrete pozitive në investime ekonomike, teknologji e inovacion, rritje pagash e ulje papunësie, kapital njerëzor e arsim profesional, mirëqenie dhe strehim, treg konkurrues e nxitje prodhimi, si dhe në ndihmën për sipërmarrjen! Në takim me homologun Márton Nagy, Ministrin e Ekonomisë Kombëtare të Hungarisë u diskutua për promovimin e bashkëpunimit ekonomik dhe mekanizmave financiare për investimet strategjike. Gjithashtu në Bankën Hungareze të Zhvillimit MFB u njohëm nga afër me aktivitetet kryesore të bankës, në mbështetje të fuqizimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si edhe me detyrat e menaxhimit të fondeve në kuadër të programeve të Bashkimit Evropian.

ÇELEN JAVËT KULTURORE NDËRKOMBËTARE


“Shqipëria mikpret botën”

Javët Kulturore Ndërkombëtare, do të rrokin tërë vendin për 7 muaj rresht, deri në Nëntor, nisur nga Tirana, për të mbushur salla, teatro e galeri arti, sheshe e agora qytetesh anembanë, sy e zemra komunitetesh, me programe të pasura aktivitetesh nga mbi 20 shtete.



TIRANA, KRYEQYTETI MESDHETAR I KULTURËS DHE DIALOGUT PËR VITIN 2025

Vizioni ynë për të ardhmen – një vizion që feston diversitetin, gjithëpërfshirjen dhe shkëmbimin e ideve midis popujve tanë. Në bashkëpunim me partnerët tanë, Unionin për Mesdheun, Anna Lindh Foundation dhe Bashkinë e Tiranës, jemi gati të shkëlqejmë në skenën ndërkombëtare të kulturës dhe dialogut. Viti 2025 premtion plot aktivitete që do të nxisin krijimtarinë, promovimin e dialogut, ndërgjegjes qytetare e përqafimit të fuqisë transformuese të artit e kulturës.



Finalja e madhe e Thirrjes së Parë për Propozime të Challenge Fund | EU4Innovation dhe ceremonia e shpalljes së fituesve

Festuarim për zgjedhjen e 20 startup-eve të shquara nga një grup prej 247 aplikantësh, të cilët do të përfitojnë shuma financimi nga 10,000 deri në 30,000 Euro. Idetë e tyre inovatore dhe shpirti sipërmarrës po ndriçojnë rrugën për një të ardhme më të ndritshme në Shqipëri.

KONTROLL AGJENCIVE PRIVATE TË PUNËSIMIT, MASA DERI NË HEQJEN E LICENCËS, KUSH NUK ZBATON LIGJIN

Të gjitha Agjensitë private të Punësimit (APP) do t'i nënshtrohen një inspektimi të posaçëm nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Ky aksion do të vlerësojë veprimtarinë dhe kushtet e këtyre agjencive, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të punëkërkuësve dhe punëofruesve, verifikimin e zbatimit të detyrimeve ligjore ndaj aplikuesve dhe punëtorëve migrantë, punësimin e denjë dhe rekrutimin etik.





Javët Kultureore Ndërkombëtare, u çel java e Francës

Hapja e Javës Kultureore Franceze në KubFrance Tirana.

KubFrance do të jetë një hapësirë immersive dedikuar realitetit virtual, artit dhe teknologjisë duke ofruar një përvojë të jashtëzakonshme kulturore dhe pedagogjike. KubFrance Tirana qendroi hapur përgjatë gjithë javës për publikun, ku secili përjetoj botën virtuale dhe dixhitale si kurrë më parë.

Aktivitetet e Javës Franceze, të shtrira midis datave 13-19 Maj, u realizuan në këtë hapësirë, në kopshtin e Piramidës dhe në Parkun e Liqenit, të gjitha falas për publikun!

MIRATOHET NË KUVEND PROJEKTIGJI PËR “MARRËVESHJEN NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË ITALISË NË FUSHËN E SIGURIMEVE SHOQËRORE”



Marrëveshja garanton që asnjë qytetar nuk humbet asnjë ditë kontribute, pavarësisht prej vendit ku ka punuar, duke mundësuar plotësimin e kushteve ligjore për përfitimin e pensionit në të dy vendet. Gjithashtu, kjo marrëveshje konsiston në ofrimin e përfitimeve në sigurimet shoqërore dhe bazohet në parimin e trajtimit të barabartë të punëtorëve në punësim, trajtimin me përfitime dhe të ardhura. Mbi 500 mijë shtetas shqiptarë, të cilët jetojnë e punojnë në Itali, pritet të përfitojnë nga kjo marrëveshje duke e prekur skemën qoftë edhe me një vit. Qeveria Shqiptare mbetet e angazhuar në garantimin e mbrojtjes shoqërore të shtetasve të saj, kudo ku ata jeto-

MBAHET DËGJESA E DYTË PUBLIKE PËR PLANIN E MENAXHIMIT TË PARKUT ARKEOLOGJIK TË BYLISIT DHE QYTETIT ANTIK TË KLOSIT

Ky plan synon rritjen dhe ruajtjen, përdorimin dhe atraksionin e aseteve të trashëgimisë kulturore në qytetet antike të Byllysit dhe Klosit. Në këtë dëgjese të dytë, u diskutua mbi objektivat e menaxhimit dhe aktivitetet kryesore të propozuara, si ruajtja dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore, përmirësimi i aksesueshmërisë, infrastrukturës civile dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë së pasurisë dhe trashëgimisë kulturore, etj.



MINISTRI GONXHJA PROPOZON NË KUVEND PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN QYTETARËT, BARAZIA, TË DREJTAT DHE VLERAT”

Ky projektligj ka synimin të nxisë konkurrencën dhe potencialin ekonomik të operatorëve shqiptarë që operojnë në fushat e mbeshtetura nga programi; të nxisë shkëmbimet ndërmjet qytetarëve të vendeve të ndryshme, veçanërisht përmes binjakëzimit të bashkive dhe rrjeteve të qyteteve të inkurajojë bashkëpunimin dhe shkëmbimet ndërmjet organizatave brenda Evropës dhe më gjerë; të mbrojë dhe promovojë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara apo të ndryshme, për përfshirjen e tyre aktive dhe pjesëmarrjen e plotë në projektet e programeve, të parandalojë dhe luftojë të gjitha format e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje, etj.



PREZANTOHET "MANUALI SHQIPTAR PËR ARTIN DHE EDUKIMIN"

Në ambientet e Bulevard Art and Media Institute dhe Destil Creative Hub, u prezantua "Manuali Shqiptar për artin dhe edukimin", një botim i cili përmban një plan kohor të Institucioneve të Artit Shqiptar, në vitet 1920 - 1989 duke u fokusuar te arkitektura e Liceut Artistik “Jordan Misja” dhe Universiteti i Arteve në Tiranë.

Botimi është shkruar nga studiuesit Jonida Gashi, Jora Kasapi, Ermir Hoxha, Raino Isto dhe Ylber Marku.



“ZGJIDH TË VENDIT”

Turizmi, për Shqipërinë ofron një shans të shkëlqyer që duhet të kapet në të gjithë dimensionin e tij. Një mundësi transformimi jo vetëm për zonat turistike, komunitetet lokale apo strukturat akomoduese, por për të gjithë ekonominë dhe sipërmarrjen shqiptare. Ndaj kjo nismë synon të përforcojë forcën transformuese të këtij sektori, duke e vendosur atë në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të prodhuesve shqiptar. Duke nxitur përfshirjen sa më të gjerë të produkteve dhe markave shqiptare në zinxhin tonë akomodues dhe duke gërshetuar më të mirën që toka dhe njerëzit ofrojnë me atë që natyra na ka falur, jemi në gjendje t'i vendosim vetes një objektivi të ri ambicioz.



ÇELET JAVA KULTURORE GREKE

Greqia, vendi i antikitetit, i demokracisë dhe filozofisë, i miteve dhe i perëndive. Një komb i pasur me kulturë dhe shije. Një javë e mbushur me aktivitete që festojnë më të mirën e kinematografisë, pikturën, poezinë, kërcimin, e shumë të tjera që ishin prej eventeve më në zë të kësaj jave.



FITUESIT E GRANTEVE “SMART&GREEN FUTURE”

Në kuadër të projektit “Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik dhe Rajonal, Nxitja e Punësimit dhe Arsimit dhe Formimi Profesional” (PROSEED 2.0), zbatuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe GIZ, dhe financuar nga qeveria gjermane, shpallëm fituesit e granteve Smart&Green Future. PROSEED 2.0 synon zhvillimin e sektorit privat, përmirësimin e punësimit dhe arsimit profesional, duke integruar elementët dixhitalë dhe të gjelbër në përputhje me prioritetet e BE-së.



Fokusi ynë mbetet rritja e punësimit dhe vetëpunësimit, rritja e konkurrencës së sektorit privat dhe zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm. 75 grante janë akorduar për sipërmarrësit dhe bizneset ekzistuese që do të integrojnë elemente të gjelbra dhe dixhitale në proceset e tyre të biznesit. Nga 204 aplikime, 35 femra dhe 49 meshkuj janë shpallur fitues, duke përfshirë sektorë si bujqësia, IT, tekstilet, turizmi, zejtaria dhe tregtia.

RRITJE SPEKTAKOLARE E NUMRIT TË VIZITORËVE NË KALA DHE MONUMENTET E KULTURËS.

Kalatë dhe monumentet e kulturës presin çdo ditë e më shumë vizitorë nga i gjithë vendi dhe bota.

- **28,658** vizitorë për periudhën Janar - Prill 2024 është rritur me **56%** në krahasim me vitin që lamë pas.
- **64,326** vizitorë në parqet tona arkeologjike gjatë 4-mujorit të parë të 2024.
- **69%** më shumë krahasuar me 2023.



JAVA E ADMINISTRATËS PUBLIKE, “FORUMI I INOVACIONIT”

Në kuadër të Javës së Administratës Publike por edhe Javës së Qeverisjes së Hapur, Forumin e Inovacionit. Në qendër të diskutimeve ishin hapat e ndërmarra deri më tani nga administrata dhe sektori privat në Shqipëri për të përqafuar inovacionin në tregun e punës, si instrument esencial në rritjen e efikasitetit, konkurrueshmërisë, por edhe transparencës.

NATA E MUZEVE

18 Maji, një ditë e jashtëzakonshme plot me aktivitete edukative, nga ekspozitat unike të punëtoritë kreative deri tek mbrëmjet magjike me programe artistike kuruar në bashkëpunim me bashkitë e vendit, rriti vizitueshmërinë e këtyre siteve në rreth 12,000 vizitorë vetëm në këtë ditë, 3-fish më shumë krahasuar me vizitueshmërinë në ditë normale.



FESTIVALI “PASQYRAT E NARCISIT”

Nisi më 22 maj në Torrën Veneciane në Durrës festivali i poezisë për të rinj “Pasqyrat e Narcizit”, një festival i konceptuar nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, si një mënyrë për të afruar sa më shumë brezin e ri me leximin dhe poezinë në veçanti.

Nata e parë kushtuar poezisë bëri bashkë poetët e prozatorët Alban Tufa, Tobias Xhaxhiu, Bujar Hoxha dhe Pol Milo, duke ofruar intepertime nga krijimtaria e tyre poetike, por edhe diskutime mbi çështje të poezisë dhe artit të letërsisë.

“Qëllimi i këtij festivali është të afrojmë më pranë lexuesit poetin dhe poezinë, të nxitë leximin dhe shkrimin e poezisë si një nga format më elokumente të artit të shkruar, njokohësisht të kthejë vëmendjen e të rinjve kah historia dhe kultura shqiptare”, u shpreh drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, Alda Bardhyli.

Tematika e natës së parë kushtuar poezisë ishte “Erosi dhe poezia”.

Si e gjen rrugën Erosi kah poezia? A është poezia areali që i tjetëron fytyrën dashurisë? Si janë raportet mes Erosit dhe poezisë? Si ka ndryshuar materiali poetik prej zanafillës poetike deri në ditët e sotme? Cilat janë temat që poetët e rinj kanë interes për të elaboruar në vargjet e tyre?

Këto ishin disa nga pyetjet që poetët e rinj ndanë me të pranishmit.

Festivali i poezisë për të rinj “Pasqyrat e Narcizit” vijoi edhe më 23 maj duke sjellë poetë të rinj në hapësirat e Torrës Veneciane në Durrës.

Si shfaqet figura e femrës në poezi? Çfarë atributësh të reja kanë vendosur poetët t’i veshin asaj? Si është femra shqiptare në vargje dhe rreshta prozaik? A ka një ngjashmëri mes femrës në letërsi dhe asaj në përditshëri? Cila është e bukura femërore në ditët e sotme në vargjet poetike?

Pyetje e çështje të tilla që lidhen me poezinë shqipe u zbuluan natën e dytë të festivalit poetik nga panelistët: Olimbi Velaj, Nurie Emrullai, Majlinda Rama, Liza Brozi dhe Ersid Karaj.

MEKI SHPALL THIRRJEN PËR KONKURSION E ARTIT GRAFIK "NOVELAT GRAFIKE SHQIPTARE 2024"

Çelet edicioni i VIII-të i Konkursit Kombëtar "Novelat Grafike Shqiptare 2024" duke ftuar të gjithë të rinjtë deri në moshën 29 vjeç për të ndarë idetë kreative në botën e veçantë të artit grafik.

Punimet më të mira do të vlerësohen me çmime!



HAPET THIRRJA E HAPUR PËR "FONDIN E TEATRIT PËR TË RINJ", EDICIONI III

Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, organizon edicionin e tretë të "Fondit të Teatrit për të Rinj" 2024.

Ky fond kërkon të sjellë në vëmendje dramaturgjinë bashkëkohore shqiptare dhe të huaj, gjithëpërfshirjen e artistëve të rinj, pasurimin e jetës teatrore shqiptare nëpërmjet kontributit dhe vizionit të të rinjve të fushës.

Projektet teatrore përfituese nga ky fond realizohen nën kujdesin e Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" në bashkëpunim me teatrot e rretheve dhe Universitetin e Arteve.



QKK HAP THIRRJEN PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE "DITË, JAVË DHE FESTIVALE FILMIT"

Shtëpitë kinematografike që do të paraqesin projekte Ditësh, Javësh dhe Festivalesh filmi, duhet të jenë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë për vitin 2024!


Aplikoni me projekte ngjarjesh që do të festojnë artin dhe passionin për kinemanë botërore, evropiane dhe shqiptare!

Afati i fundit: 12 qershor, ora 16:30.



TIRANA, KRYEQYTETI MESDHETAR I KULTURËS DHE DIALOGUT PËR VITIN 2025

Vizioni ynë për të ardhmen – një vizion që feston diversitetin, gjithëpërfshirjen dhe shkëmbimin e ideve midis popujve tanë. Në bashkëpunim me partnerët tanë, Unionin për Mesdheun, Anna Lindh Foundation dhe Bashkinë e Tiranës, jemi gati të shkëlqejmë në skenën ndërkombëtare të kulturës dhe dialogut. Viti 2025 premtion plot aktivitete që do të nxisin krijimtarinë, promovimin e dialogut, ndërgjegjes qytetare e përqafimit të fuqisë transformuese të artit e kulturës.



KONTROLL AGJENCIVE PRIVATE TË PUNËSIMIT, MASA DERI NË HEQJEN E LICENCËS, KUSH NUK ZBATON LIGJIN

Të gjitha Agjensitë private të Punësimit (APP) do t'i nënshtrohen një inspektimi të posaçëm nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Ky aksion do të vlerësojë veprimtarinë dhe kushtet e këtyre agjencive, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të punëkërkesve dhe punëofruesve, verifikimin e zbatimit të detyrimeve ligjore ndaj aplikuesve dhe punëtorëve migrantë, punësimin e denjë dhe rekrutimin etik.

MBAHET DËGJESA PUBLIKE NË KUADËR TË PËRGATITJES DHE HARTIMIT TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË ISH-BURGUT TË SPAÇIT

Një plan menaxhimi i hartuar në bashkëpunim me ish-të burgosur, ekspertë të menaxhimit të objekteve kulturore, me mbështetjen Financiare të Suedisë, si dhe me dijen dhe ekspertizën e ofruar nga CHwB Albania dhe Fondacioni Santaga, jemi të bindur që në Spaç po bëjmë diçka me të vërtetë unike, pas një analize të detajuar të pasurisë kulturore, të vlerave dhe statusit të saj të ruajtjes, si dhe pas një raundi konsultimesh edhe me grupet e interesit që përfshinin më shumë se 50 individë.



Finalja e madhe e Thirrjes së Parë për Propozime të Challenge Fund | EU4Innovation dhe ceremonia e shpalljes së fituesve

Festuar përzgjedhjen e 20 startup-eve të shquara nga një grup prej 247 aplikantësh, të cilët do përfitojnë shuma financimi nga 10,000 deri në 30,000 Euro. Idetë e tyre novatore dhe shpirti sipërmarrës po ndriçojnë rrugën për një të ardhme më të ndritshme në Shqipëri.

